

Çështja

Çdo vit rreth 30 vetë vdesin nga helmimi me monoksid karboni që shkaktohet nga instalimi i gabuar ose mirëmbajtja e keqe e pajisjeve me gaz dhe tubave të ajrosjes. Shumë të tjerë po kështu sëmurën. Kur nuk digjet si duhet gasi, siç ndodh edhe me qymyrin, drurin apo naftën, prodhohen sasi të tepërta të monoksidit të karbonit i cili është helmues.


Ai nuk mund të shihet. Ai nuk mund të shijohet. Madje nuk i ndjehet as era. Mirëpo monoksidi i karbonit mund të shkaktojë vdekjen brenda disa orëve pa patur asnjë shenjë paralajmëruese.

Rreziku është veçanërisht i madh kur jeni në gjumë, pasi nuk mund t'i dalloni simptomat e para të helmimit me monoksid karboni. Ato përfshijnë lodhjen, përgjumjen, dhimbjen e kokës, pështjellimin, dhimbje të gjoksit dhe të stomakut. Këto simptoma janë të ngjashme me shumë sëmundje të zakonshme dhe mund të ngatërrohen lehtësisht me gripin ose thjeshtë me lodhjen.

Në rast se ju ose ndonjë anëtar i familjes suaj ka simptomat e mësipërme, dhe besoni se ato mund të jenë shkaktuar nga monoksidi i karbonit, **duhet të kërkonti këshilla mjekësore urgjente**. Mjeku duhet t'ju bëjë një analizë të gjakut ose të frymëmarrjes. Monoksidi i karbonit largohet nga gjaku shumë shpejt dhe **analizat që bëhen më shumë se katër orë pas ekspozimit ndaj tij mund të jenë të pasakta**.

Rrezikoheni nga helmimi me monoksid karboni kur:

- pajisjet janë instaluar keq;
- pajisjet nuk punojnë si duhet;
- pajisjet nuk janë kontrolluar apo mirëmbajtur rregullisht;
- në dhomë nuk ka ajër të pastër të mjaftueshëm;
- oxhaku ose tubat janë bllokuar;
- lejoni inxhinierë që nuk janë të regjistruar në CORGI të instalojnë dhe mirëmbajnë pajisjet tuaja.



Rreziku është veçanërisht i madh në rast se flini në një dhomë ku një pajisje, që nuk është e futur në mur (si psh një zjarr me gaz), lihet ndezur gjatë natës. (Tubat e ajrosjes të pajisjeve të mbyllura të dhomës zakonisht vendosen në një mur të jashtëm në nivel të ulët dhe të mbrojtur nga një tip kafazi dhe jo në apo mbi nivelin e çatisë.)

Përgjigjet


ASNJËHERË mos përdorni një pajisje me gaz në rast se nuk punon si duhet. Shenjat dalluese përfshijnë flakën e verdhë ose portokalli (me përjashtim të zjarreve që rikrijojnë efektin e djegies së lëndëve djegëse në këtë ngjyrë), blözë ose njolla përreth pajisjes dhe fikja e shpeshtë e llampës pilot.

ASNJËHERË mos e mbuloni një pajisje apo bllokoni vrimat e ajrosjes.

ASNJËHERË mos bllokoni apo krijoni pengesa për grilat ose tullat e instaluara për ajrosje.

ASNJËHERË mos bllokoni apo mbuloni tubat e jashtëm.

KUJDES: Sa herë që në një dhomë ku ndodhet një pajisje me gaz instalohen pengues të erës, ventilatorë



në tavan ose thithës ajri, dritare me dubël-xham ose verandë me xhama, pajisja në fjalë duhet kontrolluar për të verifikuar se nuk është e rrezikshme.

TË GJITHË konsumatorët e gazit këshillohen t'i kontrollojnë pajisjet e tyre **të paktën çdo 12 muaj** nga një inxhinier i regjistruar në CORGI.

Ju mund të keni të drejtën e kontrollit të sigurisë falas. Në rast se jeni mbi 60 vjeç, i sëmurë kronik, me aftësi të kufizuara, shurdh ose me dëgjim të dëmtuar, i verbër ose pjesërisht i verbër, keni të drejtë të futeni në Regjistrin e Shërbimit Përparësor të kompanisë tuaj të shërbimeve. Anëtarësimi është falas dhe pas tij ju keni të drejtë, mes të tjerave, që kontrolli i sigurisë t'ju bëhet falas (përveçse kur jetoni në një shtëpi me qira ku përgjegjësinë për kontrollin e ka pronari i shtëpisë). Informata të mëtejshme gjenden në faqen e pasme të faturës së gazit.

PAJISJET E ALARMIT PËR MONOKSID KARBONI Shërbejnë si një masë mbrojtëse shtesë por **NUK** duhen parë si zëvendësues të instalimit dhe mirëmbajtjes së rregullt të pajisjeve me gaz nga një inxhinier i regjistruar në CORGI. Në rast se vendosni të blini një alarm të monoksidit të karbonit, bëni kujdes që ai të përmbushë standartet e sigurisë (BS 7860 or BS EN 50291) dhe të ketë shenjë e kontrollit. Në rast se keni dyshime, kërkonti këshilla nga një punonjës shërbimi. Ndiqni gjithnjë udhëzimet e prodhuesit për vend-vendosjen.

Në rast se ndjeni erën e gazit, ose dyshoni se po rrjedh gaz, duhet të veproni menjëherë si më poshtë:

- Hapni të gjitha dyert e dritaret.
- Ndalonni furnizimin me gaz tek rubineti që ndodhet te sahati i gazit (po ta dini ku ndodhet). Në rast se vazhdon rrjedhja e gazit telefononi **Transco në Numrin Falas të Emergjencës së Gazit 0800 111 999**.
- Kur dyshohet se ka rrjedhje të monoksidit të karbonit, ndiqni procedurën e mësipërme, me përjashtim të rasteve kur jeni vetë në gjendje të zbuloni se cila është pajisja e prishur. Në këtë rast duhet të konsultoni një inxhinier të regjistruar në CORGI për të zbuluar difektin dhe për të bërë riparimet.

Ligji

Rregullorja e 1998-ës mbi Sigurinë e Gazit (Instalimi dhe Përdorimi) parashton detyrime për konsumatorët, instaluesit e furnitorët e gazit dhe pronarët e shtëpive. Kjo rregullore ndërlidhet me kontrollin e tjera të sigurisë për pajisjet me djegie të brendshme, psh Rregulloren e Ndërtimeve, që vendos standartet për ventilimin dhe tubat e ajrosjes. Për sigurinë tuaj mos harroni:

- sipas ligjit, çdo njeri që punon me pajisje gazi ose pjesët e tyre duhet të jetë kompetent dhe i regjistruar nga CORGI (**Këshilli për Instaluesit e Regjistruar të Gazit**). Kontrolloni që instaluesi juaj të jetë i regjistruar duke i kërkuar gjithnjë që t'ju tregojë kartën fotografike të identitetit CORGI e cila ka fotografinë e instaluesit, numrin e regjistrimit nga CORGI, titullin e biznesit të tyre dhe datën e skadimit të kartës. Në anën e pasme të kartës tregohen hollësitë e punëve me gaz që mund të bëjë instaluesi. Mund t'i telefononi CORGI-t gjatë orarit zyrtar të punës në 01256 372300 ose të hyni në faqen elektronike të CORGI-t në www.corgi-gas.com;

...vazhdon në faqen tjetër

● sipas ligjit vetëm një person kompetent mund të punojë me pajisje me gaz apo pjesët e tyre. Puna amatore me pajisjet me gaz ose pjesët e tyre mund të jetë e rrezikshme dhe ka gjasa të jetë e paligjshme;

● sipas ligjit nuk duhet të përdorni pajisje me gaz të cilat e dini apo dyshoni që janë të pasigurta. Me anën e CORGI-t, HSE u ka kërkuar të gjithë instaluesve të shkëpusin lidhjen e pajisjeve me gaz apo pjesëve të tyre që janë kaq të rrezikshme sa që kërcënojnë jetën në rast se përdoren. Është në interesin tuaj, dhe të të tjerëve, që të mos kundërshtoni kur instaluesi ju kërkon leje të shkëpusë lidhjen e një pajisjeje të këtyllë. Riparojeni këtë pajisje apo pjesët e saj duke përdorur një instalues të regjistruar në CORGI para se ta përdorni sërish;

● sipas ligjit, pronarët e shtëpive janë përgjithësisht përgjegjës për mirëmbajtjen e pajisjeve të montuara me gaz dhe tubave dhe për kontrollin vjetor të sigurisë të pajisjeve me gaz dhe tubave. Ata po kështu duhet t'i ruajnë certifikatat e kontrolleve të sigurisë për të paktën dy vjet dhe certifikatën e fundit duhet t'ua japin qiraxhinjve ekzistues apo qiraxhinjve të rinj para se ata të hyjnë në shtëpi. Në rast se pajisja është juaja, atëherë ju jeni përgjegjës për mirëmbajtjen dhe kontrollin e sigurisë;

● sipas ligjit, me përjashtim të pajisjeve të mbyllura në mur, ekzistojnë kufizime mbi instalimin e pajisjeve me gaz si zjarret, boilerat, dhe ngrohëset në dhomat e fjetjes. Këto kufizime zbatohen vetëm për pajisjet e instaluara pas 1 janarit 1996 dhe atyre të instaluara në dhomat me qira të cilat janë transformuar në dhoma gjumi pas 31 tetorit 1998. Pajisjet të cilat nuk janë të mbyllura në mur, psh zjarret e zakonshme të gazit me fuqi 14 kilovat a më pak, mund të instalohen vetëm kur kanë një ndërprerës automatik të furnizimit me gaz para se

të arrihen nivele të rrezikshme gazrash. Megjithatë, në këtë lloj banese, pajisjet mbi 14 kilovat lejohen vetëm kur janë të tipit të montueshëm në mur;

● sipas ligjit, nga 31 tetori 1998, është ndaluar instalimi në çfarëdo dhome i ngrohësive të menjëhershëm të ujit të cilët nuk janë të mbyllur në mur apo që nuk kanë një ndërprerës automatik të furnizimit me gaz para se të arrihen nivele të rrezikshme të gazrave helmuese;

● sipas ligjit, transportuesit e tubit kryesor të gazit/furnizuesit e emergjencës duhet që, në rast emergjence, ta vënë situatën nën kontroll. Ata duhet të përcaktojnë shkaktuesit e rrjedhjes së gazit dhe të marrin masa për ta ndaluar rrjedhjen e gazit brenda 12 orëve. Në rastet e rrjedhjes ose dyshimit të rrjedhjes së monoksidit të karbonit ata duhet t'u përgjigjen njoftimeve të konsumatorëve dhe ta vënë situatën nën kontroll.

Lexim i mëtejshëm

Në rast se dëshironi informata më të hollësishme mbi këtë temë, atëherë lexoni këtë botim të dobishëm të HSE: *Safety in the installation and use of gas systems and appliances. Gas Safety (Installation and Use) Regulations 1998. Approved Code of Practice and guidance L56 (Second edition)* HSE Books 1998 ISBN 0 7176 1635 5.

Zyra e Zëvendës-Kryeministrit ka botuar këtë broshurë: *Danger: Carbon monoxide poisoning. Solid fuel, wood and oil burning appliances. Get them checked, sweep your chimneys and be safe* 1999. Gjendet në: Free Literature Service, PO Box 236, Wetherby, West Yorkshire LS23 7NB Tel: 0870 1226 236, Fax: 0870 1226 237, Tekst-telefon 0870 1207 405, ose kopjojeni nga interneti në faqen www.safety.odpm.gov.uk/bregs/br19.htm

Informata të mëtejshme

Botime jo falas e falas të HSE mund të porositen të vijnë me postë nga HSE Books, PO Box 1999, Sudbury, Suffolk CO10 2WA Tel: 01787 881165 Faks: 01787 313995 Faqja elektronike: www.hsebooks.co.uk (Botimet jo falas të HSE gjenden edhe në librari, ndërkohë që broshurat falas mund të kopjohen nga faqja elektronike e HSE: www.hse.gov.uk.)

Standardet britanike gjenden tek BSI Customer Services, 389 Chiswick High Road, London W4 4AL Tel: 020 8996 9001 Faks: 020 8996 7001 Faqja elektronike: www.bsi-global.com

Për informata mbi shëndetin dhe sigurinë telefononi Infolinjën e HSE Tel: 08701 545500 Faks: 02920 859260 e-mail: hseinformationservices@natbrit.com ose dërgoni letër tek HSE Information Services, Caerphilly Business Park, Caerphilly CF83 3GG.

Faqja elektronike mbi Shëndetin dhe Sigurinë e HSE: www.hse.gov.uk/gas/index.htm

Linja e Këshillave për t'u mbrojtur nga gazi e HSE

0800 300 363

Këto udhëzime janë lëshuar nga Ekzekutivi për Shëndetin dhe Sigurinë. Nuk jeni të detyruar t'i ndiqni këto udhëzime dhe jeni të lirë të veproni si të doni. Por në rast se i ndiqni udhëzimet, normalisht keni përmbushur kërkesat e ligjit. Inspektorët e shëndetit dhe sigurisë kërkojnë zbatimin e ligjit dhe mund t'u referohen këtyre udhëzimeve si shembull ilustrues i praktikës së mirë.


© Kurora ka të drejtën e autorit. Ky botim mund të riprodhohet lirish, me përjashtim të rasteve të përdorimit në rolin e reklamës, të referencës mbështetëse apo për qëllime tregtie. Botuar fillimisht 10/02. Lutemi të tregoni burimin që është HSE.

INDG238(rev2) 10/02 C7500
Printuar e botuar nga Ekzekutivi për Shëndetin dhe Sigurinë

Pajisjet me gaz

Kontrollojini
Mbajini jashtë
rrezikut

Kjo broshurë përmban informata të reja të rëndësishme. Lutemi lexojeni. Mund t'ju shpëtojë jetën.



Linja e Këshillave për Rrezikun nga Gazi e HSE - Ekzekutivi për Shëndetin e Sigurinë

0800 300 363